



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Datë/A:	30 Maj 2025
Për/Za/To:	Bashkim Ramosaj- Kryetar i Komunës
Nga/From/Od :	Ajne Iberhysaj- Zyrtare për Barazi Gjinore
Tema/Subject/Subjekt:	Procesverbal për takimin e mbajtur të Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje, ndaj Grave dhe në Baza Gjinore


Takimi i Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje, ndaj Grave dhe në Baza Gjinore, u mbajt më datë 30 maj 2025 datë 30 maj 2025, nga ora 11:00-12:00 në sallën e katit të dytë të objektit të Komunës, u organizuar nga Zyra për Barazi Gjinore në Komunën e Deçanit. Qëllimi i takimit ishte shqyrtimi i progresit të arritur deri më tani, si dhe planifikimi i aktiviteteve për periudhën në vijim. Gjatë takimit, u prezantua Plani i Aktiviteteve për vitin 2025, ndërsa z. Xhavit Nimonaj nga Stacioni i Policisë në Deçan raportoi për rastet e dhunës në familje të raportuara deri në këtë fazë të vitit. Të gjitha institucionet pjesëmarrëse kontribuan me mendimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe forcimin e mekanizmave mbrojtës për viktimat e dhunës. Po ashtu, Dr. Nusret Pepaj propozoi organizimin e një trajnimit për zyrtarët përkatës me temën: "Si të merret një deklaratë nga një person që ka përjetuar dhunë", si pjesë e përpjekjeve për rritjen e profesionalizmit në trajtimin e rasteve të tilla. Takimi u zhvillua në frymën e bashkëpunimit dhe angazhimit të përbashkët për zbatimin e Planit të Veprimit Lokal për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës në Familje dhe në Baza Gjinore në Komunën e Deçanit. Vazhdon të mbetet shqetësuese numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje, që sipas të dhënave të siguruar është në rritje. (Kisha fjalën në përgjithësi, jo për komunën e Deçanit).

Avokati i Popullit bazuar në mandatin kushtetues që ka vazhdimisht, përmes raporteve të adresuara ka tërhequr vëmendjen e autoriteteve për detyrimet pozitive të shtetit në drejtim të marrjes së masave të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtës në jete dhe mbrojtjes nga dhuna në familje, duke konstatuar se këto masa duhet të jenë të koordinuara, efektive dhe në përputhje me legjislacionin dhe procedurat standarde të veprimit....

Hasije Islami- Zyrtare e lartë Juridike- Institucioni i Avokatit të Popullit, e cila theksoj se; sipas Rregullores QRK nr.01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Ligjore, ky mekanizëm ka në përbërje Kryetarin e Komunës.

Pastaj, lidhur me trajnimin e anëtarëve të MKKKDhF-së e paraparë sipas nenit 9 të Rregullores në fjalë (QRK nr.01/2025).

Vlen të ceket fakti se kjo Rregullore në nenin 4 e përcakton përbërjen e Mekanizmit Koordinues Lokal dhe aty nuk parashihet prezenca e Institucionit të Avokatit të Popullit.



Por, në paragrafin 4 të po këtij neni thuhet : “*Mekanizmi Koordinues Lokal sipas nevojës mund të ftojë në takim edhe përfaqësues institucioneve relevante.*”

Pra është theksuar se Institucioni i Avokatit të Popullit ka rol vëzhgues në kuadër të MKKKDhF-së. Ne fund njoftova të pranishmit se bazuar në mandatin e Avokatit të Popullit, i cili heton ankesat që i pranon nga çdo person fizik apo juridik, që pretendon se të drejtat e tij janë shkelur me ndonjë ligj, veprim apo mosveprim, keqadministrim të gjitha organeve shtetërore në Kosovë, jemi në dispozicion për ndihme.

Zyra për Barazi Gjinore mbetet e përkushtuar në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe në adresimin e çështjeve që çenojnë sigurinë, dinjitetin dhe mirëqenien e qytetarëve, me theks të veçantë në mbrojtjen e viktimave të dhunës dhe promovimin e barazisë gjinore. Foto nga takimi i mbajtur.

